

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë

Varshavë, Poloni

Nga data 23 deri 26 shtator 2013

Rezoluta mbi monitorimin e faqeve të internetit dhe mbrojtjen e privatësisë

Organizatat të cilat merren me monitorimin e faqeve të internetit, mund të survejojnë pothuajse të gjitha aspektet e përdoruesve të cilët janë të lidhur në internet. Lloji i informacionit që mblidhet në këtë mënyrë (p.sh. adresa IP, identifikuesit e aparateve të përdorura) mundëson ndonjëherë të identifikohet individi i shënjestruar, po aq saktë sa organizatat mund të përpunojnë një profil të hollësishëm të aktiviteteve në internet të një personi të identifikueshëm, në periudha të gjata.

Të dhënat mbi aktivitetin e përdoruesve, të cilat mblidhen me anë të një kompjuteri apo të një aparature tjetër (p.sh. një telefoni inteligjent), gjatë përdorimit të shërbimeve të ndryshme të ofruara nga shoqëria e informacionit në internet, janë gjithnjë e më shpesh të kombinuara, të ndërlidhura dhe të analizuar nga aktorë të ndryshëm dhe për qëllime të ndryshme, veçanërisht për qëllime bamirësie apo biznesi, në funksion të aktiviteteve të palëve të cilat ofrojnë këto shërbime plotësisht apo pjesërisht. Profilet e interesit (apo “profilet e përdoruesve”) të gjeneruara, mund të pasurohen me anë të informacionit që vjen nga “bota jashtë internetit”, praktikisht mbi të gjitha aspektet e jetës private, midis të cilave informacionet financiare dhe të natyrave të tjera, për shembull të zbavitjeve, probleme shëndetësore dhe bindjeve politike e fetare.

Ne pranojmë që monitorimi sjell disa përparësi për konsumatorët, veçanërisht në atë që ka të bëjë me menaxhimin e rrjetit, sigurinë dhe parandalimin e mashtrimit dhe se mund të lehtësojë paraqitjen e produkteve të rinj dhe shërbimeve. Në një shoqëri të përqendruar tek informacioni, ky aktivitet i ri paraqet gjithsesi një rrezik të pa precedent të cenimit të jetës private të të gjithë qytetarëve, për shkak se ai mund të nxisë dobësimin dhe e kalimin e kohës zhdukjen e disa parimeve themelore të mbrojtjes së privatësisë: transparencës, kufizimit të qëllimit dhe zotërimit i të dhënave nga subjekti.

Për rrjedhojë, të gjitha palët pjesëmarrëse, përfshirë edhe qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe ata që ofrojnë shërbimeve, duhet t'i japin përparësi mbrojtjes së privatësisë që nga konceptimi i shërbimeve, ashtu si edhe në kuadër të ofrimit dhe përdorimit të shërbimeve që lidhen me shoqërinë e informacionit.

Konferenca ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë, nxit kështu të gjitha palët e përfshira:

- në respektimin e parimit të kufizimit të qëllimit;
- në njoftimin e përdoruesve për përdorimin e elementit të monitorimit, përfshirë edhe mbledhjen e gjurmëve me ndihmën e një aparature apo të navigatorit dhe t'u mundësohet që këto elemente të jenë në dorën e tyre;
- të shmangin krijimin, si derivat, të një tërësie elementesh informacioni (gjurmësh) me qëllim identifikimin dhe survejimin e përdoruesve, për qëllime të tjera përveç sigurisë dhe parandalimit të mashtrimit, apo menaxhimit të rrjetit;
- të garantojnë transparencë të plotë për sa i përket të gjitha llojeve të praktikave të monitorimit të faqeve të internetit, me qëllim që t'u mundësohet konsumatorëve që të bëjnë zgjedhje të qarta;
- t'u ofrojnë përdoruesve mjete të lehta, që u mundëson atyre të njohin mjaftueshëm mbledhjen dhe përdorimin e informacioneve të tyre personale;
- të shmangin kryerjen e monitorimit të aktivitetin në linjë të fëmijëve apo mbi faqet e internetit të destinuara për fëmijët, përveçse nëse është e mundur që të verifikohet nëse një prind e ka dhënë pëlqimin për monitorimin;
- të respektojnë parimin e respektimit të privatësisë, që nga konceptimi dhe të kryejnë një vlerësim të faktorëve që kanë të bëjnë me privatësinë në fillim të projekteve të rinj;
- të përdorin teknika që zvogëlojnë ndikimin tek jeta private, veçanërisht depersonalizimin dhe përdorimin e pseudonimeve;
- të promovojnë miratimin e normave teknike, që synojnë t'u japin përdoruesve kontroll më të madh (p.sh. normën e ndalimit të monitorimit).

Komisioneri i informacionit i Republikës së Sllovenisë dhe autoriteti francez i mbrojtjes së të dhënave, abstenuan në votimin e kësaj rezolute.